UDHËZIM
Nr. 15, datë 2.5.2018

MBI PROGRAMET E ZHVILLIMIT EKONOMIK TË SHOQËRIVE TREGTARE ME KAPITAL SHTETËROR

Në mbështetje të ligjit nr. 7926, datë 20.4.1995, "Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare", i ndryshuar, ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, me qëllim njësimin e procedurave të hartimit, shqyrtimit dhe miratimit të programeve të zhvillimit të shoqërive ku ministria përgjegjëse për ekonominë, është përfaqësuese ligjore e pronarit shtetëror, miratohet udhëzimi që vijon:

I. Procesi i hartimit të programeve të zhvillimit ekonomik

1. Programe të zhvillimit ekonomik hartojnë të gjitha shoqëritë publike me kapital shtetëror

2. Hartimi i programeve të zhvillimit ekonomik të këtyre shoqërive bëhet për periudha 1-vjeçare, afatmesme dhe afatgjata, në përputhje me objektivat e caktuara nga organet drejtuese të tyre.

3. Hartimi i programeve të zhvillimit ekonomik mbështetet në Strategjinë Kombëtare të Zhvillimit Ekonomik e Social, në strategjitë sektoriale përkatëse si dhe në aktet ligjore e nënligjore në fuqi.

4. Hartimi i programeve vjetore të zhvillimit ekonomik, kryhet nga drejtoritë e shoqërive dhe miratohet nga Këshilli Mbikëqyrës.

5. Programet e zhvillimit ekonomik, së bashku me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të shoqërive me kapital shtetëror përcillet për miratim përfundimtar në ministrinë përgjegjëse për ekonominë.

6. Për shoqëritë strategjike, portet dhe shoqëritë që subvencionohen nga ministritë e linjës administrative, pas miratimit nga Këshilli Mbikëqyrës do të kërkohet mendimi i ministrive përkatëse. Projektprogrami i shoqëruar me vendimin e këshillit mbikëqyrës dhe prononcimin e ministrisë së linjës administrative do të përcillet për miratim përfundimtar në ministrinë përgjegjëse për ekonominë.

7. Programi i zhvillimit në shoqëritë ku shteti zotëron mbi 50 për qind të paketës së aksioneve, shqyrtohen dhe miratohen nga Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve. Përfaqësuesi i autorizuar i aksionarit shtetëror në mbledhjen e Asamblesë, shpreh qëndrimin zyrtar përkatëse të ministrisë përgjegjëse për ekonominë.

8. Programet e zhvillimit ekonomik në shoqëritë ku shteti zotëron nën 50 për qind të paketës së aksioneve, shqyrtohen dhe miratohen nga Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve. Përfaqësuesi i autorizuar i aksionarit shtetëror në mbledhjen e asamblesë, shpreh qëndrimin zyrtar përkatës të ministrisë përgjegjëse për ekonominë.

II. Procedura e miratimit të programeve të zhvillimit

1. Programet e zhvillimit ekonomik të shoqërive me kapital shtetëror, miratohen përfundimisht nga ministria përgjegjëse për ekonominë, me cilësinë e pronarit të pronës shtetërore.

2. Praktika e projektprogramit që propozohet për miratim përfundimtar në ministrinë përgjegjëse për ekonominë duhet të përmbajë:

- Tabelën me treguesit kryesorë të programit të zhvillimit, për vitin programues dhe parashikimin për dy vitet pasardhëse.
- Relacionin shpjegues të administratorit të shoqërisë, mbi projektprogramin ekonomik që propozojnë për miratim.
- Vendimin e Këshillit mbikëqyrës mbi projektprogramin ekonomik.
- Mendimi i ministrive të linjës administrative për shoqëritë e specifikuara në pikën 6 të këtij udhëzimi.

III. Afatet e hartimit, shqyrtimit dhe miratimit të programeve të zhvillimit

1. Ministria përgjegjëse për ekonominë, brenda datës 30 tetor të çdo viti, u dërgon shoqërive udhëzimin metodik me treguesit kryesorë që duhet të përmbajë hartimi i programit të zhvillimit ekonomik për vitin pasardhës.

2. Drejtoritë e shoqërive ku shteti ka mbi 50% të aksioneve, hartojnë projektprogramet dhe dërgojnë kopje të tyre, me relacionin shpjegues pranë këshillave mbikëqyrëse, brenda datës 1 dhjetor të çdo viti.

3. Ministritë që përfaqësojnë linjën adminis-trative të shoqërive strategjike, portret dhe shoqëritë që subvencionohen nga këto ministri, pasi i shqyrtojnë programet e zhvillimit, formulojnë qëndrimet përkatëse për treguesit kryesorë të tyre, brenda datës 30 janar të çdo viti.

4. Drejtoria e administrimit të pronës shtetërore në ministrinë përgjegjëse për ekonominë, brenda muajit janar të çdo viti monitoron dhe shqyrton praktikat e projektprogrameve të zhvillimit ekonomik, të propozuara nga organet drejtuese të shoqërive.

5. Ministria përgjegjëse për ekonominë miraton projektprogramin e secilës shoqëri me pjesëmarrje mbi 50% kapital shtetëror, brenda muajit shkurt të çdo viti.

6. Për raste të veçanta, kur propozohen ndryshime në programin e miratuar nga ministria përgjegjëse për ekonominë ndiqet e njëjta procedurë për miratimin e ndryshimit në programin e zhvillimit, si në rastin e miratimit të programit fillestar të shoqërisë. Nëse ndryshimet në programin ekonomik të zhvillimit, konsistojnë brenda zërave të miratuar nga ministria përgjegjëse për ekonominë, miratimi i këtij ndryshimi bëhet vetëm me vendim të Këshillit Mbikëqyrës.

Udhëzimi nr. 394, datë 21.8.2014 "Mbi programet e zhvillimit ekonomik të shoqërive tregtare me kapital shtetëror" shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I FINANCAVE
DHE EKONOMISË
Arben Ahmetaj